



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada-Government
Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science

Departamenti i Arsimit të Lartë dhe Shkencës

Departamenti i Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Këshilli Shkencor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në mbështetje të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore Shkencore, dt. 28 mars 2013 (Gazeta zyrtare nr. 11/02 maj 2013) dhe Udhëzimit administrativ nr. 01/2017, dt. 30.01.2017 për mbështetjen financiare për aplikim të fondeve nga MASHT për botime dhe publikime shkencore në revista me faktor ndikimi, shpall:

KONKURS

(Për financimin e botimeve dhe publikimeve shkencore në revista me faktor ndikimi për vitin 2026)

- MASH/ DALSH, mbulon shpenzimet e publikimeve për revista shkencore të indeksuara në Web of Science dhe Scoopus me faktorë ndikimi pozitiv të autorëve, të cilët punën e tyre kërkimore e realizojnë në institucionet kërkimore-shkencore të Kosovës.
- Financohen botime / publikimet nga fushat prioritare shkencore të parapara në Programin Kombëtar të Shkencës:

Fushat shkencore prioritare për aplikim:

1. Burimet Natyrore, Energjia dhe Mjedisi.
2. Prodhimi Bujqësor.
3. Studimet Mjekësore.
4. Studimet Ekonomike dhe Sociale.
5. Studimet Gjuhësore, Kulturore dhe Historike.
6. Hulumtime Ndërdisciplinare për Teknologjitë e Komunikimit dhe Informacionit.

Kush mund të aplikojë?

- Aplikimet për botime/ publikime të veçanta bëhen vetëm prej personit fizik.
- Të drejtë aplikimi kanë vetëm punëtorët shkencorë që punojnë në Institucione kërkimore shkencore.
- Merren parasysh botimet/publikimet e individëve dhe institucioneve që e ushtrojnë veprimtarinë shkencore në Republikën e Kosovës.
- Aplikimi bëhet vetëm prej autorëve të parë, për punimet e publikuara gjatë vitit akademik 2025/26.

Për aplikim për botim duhet të plotësohen këto dokumente/dëshmi:

- Letërnjoftimi i aplikuesit (kopja);
- Aplikacioni i plotësuar;
- Kopja fizike e publikimit të punimit, me header të revistës së publikimit të punimit, në Scopus ose në Web of Science;
- Webfaqja e printuar e publikimit të punimit në Scopus ose Web of science: ku paraqitet emri i punimit, emri i autorit dhe viti i publikimit;
- Deklarata e noterizuar nga autori që punimi nuk është i botuar pjesërisht apo tërësisht më herët dhe që nuk ka sponsorë të tjerë;

- Transaksioni i pagesës në emër të tij (autorit);
- Dëshmia nga Universiteti / Kolegji për punimin i cili nuk është rimbursuar nga ana e Institucionit ku autori punon;
- Kërkesat tjera në bazë të UA për botime dhe publikime shkencore në revista me if.

Sqarime shtesë:

- Financohen vetëm dy punime të një autori, të publikuara në revista që janë të indeksuara dhe të listuara në platformen Scopus dhe Web of Science, brenda një viti.
- Për revistat e listuara në Q1, kompensimi bëhet deri në 80% të vlerës e jo më shumë se 1500 €.
- Për revistat e listuara në Q2, kompensimi bëhet deri në 80% të vlerës e jo më shumë se 1200 €.
- Për revistat e listuara në Q3, kompensimi bëhet deri në 50% të vlerës e jo më shumë se 800 €.
- Për revistat e listuara në Q4, kompensimi bëhet deri në 50% të vlerës e jo më shumë se 600 €.
- Kërkesat tjera në bazë të UA për botime dhe publikime shkencore në revista me if.

Konkursi mbetet i hapur nga: **14.05.2026 deri më 30.09.2026**

- Aplikacioni me dokumentacion të kompletuar dorëzohet në arkivin e MASH, zyra nr.4, ndërsa të gjitha informatat rreth aplikimit, merren në zyrën nr. 302/b, kati 3, te z. Fidan Kozhani.

Formularin dhe dokumentacionin shtesë mund ta gjeni në webfaqen e MASH-it: <https://mash.rks.gov.net/alldocuments/formulari-per-botime-me-impakt-faktor-2026/>

Dokumentacionet e pakompletuara dhe aplikimi me vonesë nuk shqyrtohen

Detajet e kontaktit;

Emri: Fidan Kozhani

Posta elektronike :

e-mail: fidan.kozhani@rks-gov.net, Adresa postare:

Rr. Agim Ramadani p.n 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel.+381(0) 38 600 65082